




Nr. 30 prot
Shkollën 14/06/18

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 21 Datë 07.03.2018

**PËR MOSMIRATIM NË PARIM TË KËRKESËS PËR PËRDORIM TË BURIMIT
UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE SUBJEKTIT "O.SEJDI HC" SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pikës 2, të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni", për paisjen me autorizim (miratim në parim) të subjektit "**O.SEJDI HC**" sh.p.k., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

- 1-Mosmiratimin në parim të kërkesës së subjektit "**O.SEJDI HC**" sh.p.k., me administrator Z.Olsi SEJDI, për përdorim të burimit ujor **Përroi i Kaziakut**, degë e Lumit Zalli i Bulqizës, për prodhim energjie (HEC LIQENI BARDHË), elektrike në Valikardhë, Njësia Administrative Zerqan, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.
- 2- Kjo kërkesë nuk është miratuar për arsyet e mëposhtme:
 - Shkatërron mjedisin dhe turizmin
 - Vështirëson jetën sociale dhe ekonomike të banorëve me cënimin e ujit të pijshëm dhe ujit për nevojat e bujqësisë në zonë.
- 3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Çesk MILLJA

